

Mbi bazë të nenit 154-k paragrafi (4) i Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010,44/2011, 188/2013 dhe 43/2014) Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve miratoi

RREGULLORE

për kriteret lidhur me kushtet hapësirore dhe pajisjet materiale-teknike dhe informatike në mjediset për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve për përfaqësim në sigurime

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore përshkruan kushtet hapësirore dhe pajisjet materialo-teknike dhe informatike në ambientet për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve për përfaqësim në sigurime (në tekstin e mëtejme: provim profesional për broker dhe provim profesional për përfaqësues) që duhet t'i plotësojë personi juridik i cili e mban provimin profesional për broker respektivisht, provimin profesional për përfaqësues.

Neni 2

(1) Çështje teknike që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e provimit profesional për broker ose provimin profesional për përfaqësues zhvillohet nga një person juridik i veçantë i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(2) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni zgjidhet nga Komisioni për Zbatimin e provimit profesional për broker respektivisht Komisioni për mbajtjen e provimit profesional për përfaqësues, i formuar nga Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

II. KUSHTET HAPËSIRORE, PAJISJET MATERIALO-TEKNIKE DHE INFORMATIKE NË QENDRËN E PROVIMIT

Neni 3

(1) Personi juridik i përmendur në nenin 2 të kësaj rregulloreje, duhet që të ketë pronën e tij ose të ketë me qira mjediset dhe kapacitetet materiale-teknike të nevojshme për të ushtruar aktivitetin për organizimin dhe mbajtjen e provimit profesional për broker dhe provimin profesional për përfaqësues.

(2) Në selinë e personit juridik duhet të ketë dy mjedise speciale të pajisura me pajisje informatike, lidhje interneti, pajisje për inçizimin e provimit dhe displej për publikimin e rezultateve me dimensione të paktën 2x2 metra.

(3) Çdo mjedis më vete duhet të jetë i mobiluar për të paktën 30 kandidatë për provimin.

(4) Mjediset duhet të jenë operative çdo ditë pune nga e hëna deri të premten, nga ora 08:00 deri në orën 18:00.

(5) Gjatë dhënies së provimit profesional për broker, respektivisht provimit profesional për përfaqësues, në ambientet ku jepet provimi duhen të jenë të pranishëm dy administratorë të siguruar nga personi juridik.

Neni 4

(1) Personi juridik duhet të posedojë pajisje kompjuterike të përshtatshme dhe një aplikacion softuer që mundëson krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të të dhënave të vetme për mbajtjen e provimit profesional për broker, respektivisht provimit profesional për përfaqësues, për dokumentacionin, për analizën dhe mbikëqyrjen profesionale të zbatimit të provimit profesional për broker, respektivisht provimit profesional për përfaqësues.

(2) Përveç pajisjeve informatike dhe aplikacionit special të softuerit të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, personi juridik duhet të ketë:

1. akses për të përdorur aplikacionin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për mbajtjen e provimit elektronik të provimit profesional për broker, respektivisht provimit profesional për përfaqësues;
2. lidhje interneti për selinë e personit juridik të paktën 10mb / s, që do të përdoret ekskluzivisht për dhënien e provimin elektronik për broker, respektivisht provimin profesional për përfaqësues.

Neni 5

Sistemi që do të përdoret për dhënien e provimit profesional për broker, respektivisht provimin profesional për përfaqësues, duhet të përputhet plotësisht me ligjet në fuqi të cilat e rregullojnë këtë lëndë, përfshirë edhe pjesën e sezoneve të provimeve gjatë gjithë vitit.

III. SOFTUER PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR BROKER OSE PËR PËRFAQËSUES NË MËNYRË ELEKTRONIKE

Neni 6

1) Me softuerin për dhënien e provimit profesional për broker, respektivisht provimin profesional për përfaqësues në mënyrë elektronike duhet të arrihen këto objektiva:

1. Vlerësimi i profesionalizimit, kompetencës dhe etikës së kandidatëve për dhënien e provimit profesional për broker ose provimin profesional për përfaqësues; dhe
2. Zbatim efikas, ekonomik dhe transparent të provimit profesional për broker, respektivisht provimin profesional për përfaqësues.

(2) Sistemi softuerik i testeve është një bazë ndërlidhëse e të dhënave dhe përmbledhje e disa moduleve të ndryshme në funksion të nënsistemeve. Secili prej moduleve të veçantë brenda sistemit për të punuar me teste duhet ta mundësojë dhe realizojë funksionimin e duhur.

(3) Sistemi duhet të mbështesë përpunimin e njëkohshëm të një numri të madh të kërkesave të përdoruesve, pa ndërprerë funksionimin e tij.

(4) Sistemi për të punuar me teste duhet të jetë në gjuhën maqedonase dhe të ketë mështetje gjuhësore të alfabetit cirilik dhe atij latin.

(5) Zgjidhja e softuerit duhet të sigurojë besueshmëri të lartë, fleksibilitet dhe mundësi të azhurnimit në të ardhmen dhe të mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme dhe mundësia e parregullsive gjatë zgjidhjes së testeve.

(6) Akses në modulet që janë pjesë përbërëse e zgjidhjes të softuerit të përdoruesit me privilegjet përkatëse duhet të regjistrohen në regjistrat e duhur.

(7) Zgjidhja e softuerit duhet të mundësojë krijimin e raporteve të sigurisë për përdorimin dhe aksesin në aplikacion bazuar në disa parametra të ndryshëm.

Neni 7

(1) Gjatë përgatitjes së aplikacionit duhet që të ndiqen rekomandimet OWASP për siguri.

(2) Protokollet e sigurisë (SSL minimale) përdoren për të gjitha komunikimet.

(3) Siguria e plotë e sistemit duhet të sigurohet në nivelin e softuerit, pra nga vetë sistemi.

(4) Aksesin në serverin qendror duhet të sigurohet gjithashtu duke përdorur listat e hyrjes vetëm nga vendet e specifikuara (stacionet e punës të klientit).

(5) Aksesin në aplikacion duhet të mbrohet me fjalëkalim.

(6) Aksesin në bazën e të dhënave në të cilën operon aplikacioni duhet të mbrohet me fjalëkalim.

(7) Fjalëkalimet duhet të ruhen në të njëjtin server të të dhënave dhe të kodohen.

(8) Aplikacioni duhet të sigurojë një sistem për krijimin e profileve të përdoruesve siç janë kombinimi i privilegjeve të njohura.

(9) Stacionet e klientëve ku jepet provimi profesional për broker, respektivisht provimi profesional për përfaqësues nuk duhet të ketë akses në internet dhe i gjithë sistemi duhet të jetë i siguar nga ndërhyrjet e jashtme.

(10) Aplikacioni duhet të mundësojë krijimin dhe azhurnimin e regjistrave në të cilat mbahet evidenca për të gjitha plotësimet dhe futjen e të dhënave me të cilat punon aplikacioni.

(11) Për çdo ndryshim në aplikacion duhet të mbahet evidencë, përfshirë edhe kohën kur është bërë aplikacioni, si dhe informacion rreth personit me privilegje përkatëse i cili e bëri aplikimin, respektivisht plotësimin.

(12) Aplikacioni duhet të gjenerojë raporte të automatizuara të sigurisë një herë në muaj dhe manualisht ad-hock (nëse kërkohet) me kërkesë të një administratori me privilegje përkatëse, ku do të evidentohet në cilën kohë, pas kujt stacioni të punës dhe kush ka hyrë në aplikacion, si dhe nga cilat module u hapën dhe nga cilat të dhëna aplikacioni është i aksesueshëm në rast të azhurnimeve të bazës së të dhënave.

(13) Raportet dhe regjistrat e sigurisë duhet të mbrohen nga ndryshimi dhe fshirja dhe akses mund të kenë vetëm administratorët me privilegje përkatëse.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 8

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërsa fillon të zbatohet nga 09.01.2015.

Nr. 0201-526/5

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve

18.07.2014

Shkup

Dr. Klime Poposki